



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA		AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR AGJENCIA ZA VAZDUSHO NAVIGACIJSKE USLUGE AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E ARKIVES KANÇERARPIJA ARHIVA ARCHIVES OFFICE			
Nr. fq. Br. str. Pg. no.	11	Data Datum Date	04.11.21
Nr. prot. Br. prot. Prot. no.	0447	N-5	LIPJAN, RKS

Rregullore për Procedurat e Rekrutimit të Kontrollorëve të Trafikut Ajror

Versioni 1.1

Nr. Ref.: ASHNA-REK-KTA

Data e Ver.: .21.10.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

Hyrje

Kjo rregullore është pronë e:

Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror
10070 Vrellë, Lipjan
Republika e Kosovës

Prona intelektuale e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) mbrohet në bazë të Ligjit Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Çdo kopjim ose riprodhim i këtij materiali pa lejen me shkrim të publikuesit është i ndaluar.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë procesit të rregulluar të shpërndarjes ose trajnimeve të brendshme të ASHNA-s do të konsiderohet si shkelje e procedurave të ASHNA-s dhe në kundërshtim me ligjin.

Samir Bllacaku
Drejtor



Njësia Organizative: ASHNA
Nr. Ref./Kodi: ASHNA – REK – KTA
Ver.: 1.1
Data e Ver.: 21.10.2021

Faqe 2 nga 11



Aprovimi

	Emri/Pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Arben Bytyqi, Kryetar, Udhëheqës i Divizionit Kullë,	27.10.2021	
	Besian Hysaj, Udhëheqës i Divizionit Vajtje/Ardhje	27.10.2021	
	Driton Ujkani, Menaxher i DBNJ	27.10.2021	
	Ilir Dukolli, Zv. Udhëheqës i Divizionit të Trajnimit	29.10.2021	
	Zgjim Topxhiu, Kryetar i SINKON	27.10.2021	
Kontrolli i Cilësisë nga:	Armend Mustafa, Menaxher i DCSS	04.11.2021	
Aprovuar nga:	Samir Bllacaku, Drejtor	04.11.2021	

Regjistrimi i ndryshimeve

Versioni-revidimi	Data e revidimit	Faqet e afektuara	Vërejtje
Original	31.12.2018	Të gjitha	Në fuqi nga 01.01.2019
Revidim	21.10.2021	Të gjitha	Në fuqi nga 01.11.2021

Lista e shpërndarjes

Kopja	Vendndodhja	Forma	Copë
1	Libraria e ZYDR	E shtypur	1
2	Libraria e DBNJ	E shtypur	1
3	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (SMD)	Elektronike	1
4	Arkivi i ASHNA-së	E shtypur	1
5	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AACK)	E shtypur	1
6	Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, MAP (DASHC)	E shtypur	1
7	Zyra e DATS	E shtypur	1





Lista e faqeve efektive

Kapitulli	Faqet	Nr. i revidimit	Data e hyrjes në fuqi
Hyrje	2/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Aprovimi/Regjistrimi i Ndryshimeve/Lista e shpërndarjes	3/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Lista e faqeve efektive / Shkurtesat	4/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Shkurtesat	6/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Përmbajtja	5/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Qëllimi / Fushëveprimi / Inicimi i procesit të rekrutimit të KTA / Procedura e rekrutimit	6/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Kriteret e konkursit	7/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Testimi i kandidatëve	8/11	Versioni 1.1	01.11.2021
	9/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Lista përfundimtare / Statusi i nëpunësit nëpër faza / Të drejtat dhe detyrimet/ Përfaqësimi sindikal i Kontrollorit të ardhshëm të Trafikut Ajror	10/11	Versioni 1.1	01.11.2021
Skema e kompensimit të nëpunësit / Dispozitat kalimtare	11/11	Versioni 1.1	01.11.2021

Shkurtesat

Shkurtesa	Kuptimi
AACK	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
AMC	Aeromedical Centres
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
CEFR	Common European Framework of Reference for Languages
DATS	Departamenti i Shërbimeve të Trafikut Ajror
DBNJ	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DCSS	Departamenti për Cilësi, Siguri dhe Sigurim
ELPAC	English Language Proficiency Aeronautical Communication
FEAST	First European Air Traffic Controller Selection Test
KTA	Kontrollor i Trafikut Ajror
OSHNA	Ofrues i Shërbimeve të Navigacionit Ajror
SINKON	Shoqata Sindikale e KTA
SMD	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (<i>Document Management System</i>)
UTP	Unit Training Plan
ZYDR	Zyra e Drejtorit





Përmbajtja

Lista e fazeve efektive.....	4
Shkurtesat	4
1. Qëllimi	6
2. Fushëveprimi.....	6
3. Inicimi i procesit të rekrutimit të KTA-ve	6
4. Procedurat e rekrutimit.....	6
5. Kriteret e konkursit.....	7
5.1 Procedurat e shpalljes së konkursit.....	7
5.2 Kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta.....	7
5.3 Dokumentet e nevojshme për aplikim	7
5.4 Shkathësitë e kërkuara nga kandidatët	7
5.5 Detyrat kryesore.....	7
6. Testimi i kandidatëve	8
6.1 Testimi fillestar	8
6.2 Testimi profesional.....	8
6.3 Testet / kontrollet mjekësore.....	9
7. Lista përfundimtare.....	9
8. Statusi i nëpunësit nëpër faza	9
8.1 Kandidat për Student-Kontrollor.....	9
8.2 Student Kontrollor.....	9
8.3 Kontrollor i Trafikut Ajror	10
9. Të drejtat dhe detyrimet	10
9.1 Në raport me nëpunësin	10
9.2 Në raport me ASHNA-në	10
10. Përfaqësimi sindikal i Kontrollorit të ardhshëm të Trafikut Ajror.....	10
11. Skema e kompensimit të nëpunësit.....	10
12. Dispozitat kalimtare	11





Në mbështetje të Neneve 5.6, 7, 9 dhe 22 të Ligjit Nr.04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28-2014 / 28 prill 2014), të Rregullores 19-2017 të AACK-së dhe të Planit të Trajnimeve të DATS (UTP)

Nxjerr

Rregulloren

për

Procedurat e Rekrutimit të Kontrollorëve të Trafikut Ajror

1. Qëllimi

Kjo rregullore përcakton procedurat, statusin dhe skemën për rekrutimin e Kontrollorëve të Trafikut Ajror (KTA) në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen vetëm në procesin e rekrutimit të Kontrollorëve të Trafikut Ajror.

3. Inicimi i procesit të rekrutimit të KTA-ve

Procesi i rekrutimit të KTA-ve fillon me kërkesen e Menaxherit të DATS për shtimin e numrit të KTA-ve, pas një analize të detajuar apo si e gjetur e një vleresimi të sigurisë, me qëllim eliminimin e ngarkesave të tepërta të personelit, shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, shpërndarjen më të mirë të punëve ditore, uljen e pragut të orëve operative dhe të ngjashme.

4. Procedurat e rekrutimit

- 4.1 Departamenti i Burimeve Njerëzore (DBNJ) pas marrjes së autorizimeve përkatëse, bën shpalljen e konkursit në pajtim me këtë rregullore.
- 4.2 Krahas me shpalljen e konkursit, DBNJ dhe Zyra e Drejtorit (ZYDR) në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve të Trafikut Ajror (DATS), do të zhvillojë fushatë shumëdimensionale, me qëllim senzibilizimin e publikut për hapjen e konkursit. Duhet pasur parasysh që grupmoshat e kërkuara janë të reja dhe fushata mediale duhet të përshtatet për këto grupmosha duke shfrytëzuar jo vetëm mediat vizive dhe të shkruara por edhe rrjetet sociale duke krijuar reklama të sponsorizuara.





5. Kriteret e konkursit

5.1 Procedurat e shpalljes së konkursit do të organizohen në pajtim me Ligjin të Punës të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-212.

5.2 Kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për t'u plotësuar nga kandidatët janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik;
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas kësaj Rregulloreje;
- Te jetë ndërmjet moshës 18 deri 25 vjeçare;
- Te ketë diplomë të shkollës së mesme apo diplomë që u mundëson qasje në universitet apo ekuivalent.

5.3 Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari për aplikim
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës
- Vërtetim mbi të kaluarën kriminale nga Policia
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata
- Kopjet e dokumentacionit të nevojshëm për vendin e punës.

5.4 Shkathtësitë e kërkuara nga kandidatët:

- Të demonstrojë aftësi të larta komunikuese dhe në të shkruar në gjuhën angleze (së paku nivelin B2 sipas CEFR - Common European Framework of Reference for Languages);
- Aftësi në orientim hapësinor dhe përpunim të shpejtë të informacionit;
- Aftësi për të menduar dhe për t'u shprehur rrjedhshëm dhe logjikshëm;
- Aftësi për të punuar si pjesë e një ekipi por edhe i pavarur;
- Në hap me teknologjinë e kohës dhe i adaptueshëm për ndryshim.

5.5 Detyrat kryesore:

- Të kalojë me sukses të gjitha fazat e trajnimit të përshkruara në UTP;
- Të respektojë në përpikmëri udhëzimet dhe këshillat e Instruktorit;
- Të kalojë me sukses vlerësimin final për licencim;
- Të ketë çasje proaktive gjatë trajnimit dhe dëshirë për të përfutur shkathtësitë e nevojshme;
- Të mirëmbajë ditarin personal të trajnimit dhe të sigurohet që çdo raport të jetë i nënshkruar nga autoritetet përkatëse;





- Të respektojë në përpikmëri rregulloret dhe kërkesat administrative të ASHNA-së, hierarkinë dhe ndarjen ditore të përgjegjëse;
- Të raportojë përmes Raportimit Obligues dhe Vullnetar të Ndodhive çdo devijim nga procedurat standarde të operimeve.

6. Testimi i kandidatëve

6.1 Testimi fillestar

6.1.1 Komisioni duhet të sigurojë testim të drejtë dhe të paanshëm për të gjithë kandidatët. Testi fillestar përzgjedhës (me shkrim dhe me gojë) do të përshtatet për nevojat e ASHNA-së duke u fokusuar më shumë në testimin e gjuhës dhe aftësive të përgjithshme profesionale. Më saktë, testi do të përmbajë:

- 10% pyetje nga personaliteti
- 10% pyetje nga njohuri të përgjithshme
- 40% pyetje nga gjuha angleze
- 40% pyetje dhe detyra profesionale (aritmetikë, fizikë, logjikë e të ngjashme)

6.1.2 Kandidatët që do të arrijnë pragun prej 70% do të llogariten si të suksesshëm dhe do të përzgjidhen për t'iu nënshtruar testimit profesional. Rezultati i testit sipas pikës 6.1.1 nuk do të përfshihet në llogaritjen finale të pikëve. Pikët e fituara në testimin profesional duhet të jenë ato që përcaktojnë kandidatët e përgjegjshëm për student-kontrollor.

6.2 Testimi profesional

6.2.1 Udhëzimet që dalin nga EASA Guidelines për aplikimin e Rregullores 340/2015 (Acceptable Means of Compliance and Guidance Material to Part ATCO, Part ATCO.AR & Part ATCO.OR) të transpozuar nga AACK me Rregulloren 19-2017, kërkojnë që kandidati për student-kontrollor duhet të jetë i aftë nga aspekti arsimor, mental dhe fizik.

6.2.2 Për të arritur këto standarde, testimi profesional do të përmbajë së paku:

- Testin e personalitetit (personality test)
- Testin e gjuhës angleze (English test)
- Përlllogaritjen mendore (mental arithmetic)
- Marrjen e vendimeve (decision-making)
- Arsyetimin logjik (logical reasoning)
- Mbamendjen operative (working memory)
- Perceptimin vizual (visual perception)
- Vëmendjen (attention)
- Orientimin hapësinor (spatial orientation)
- Kryerjen e detyrave të shumëanëshme njëkohësisht (multi-tasking ability)
- Menaxhimin e stresit (stress management)





- 6.2.3 Për të testuar aftësitë e lartëcekuara, do të përdoret testi evropian për përzgjedhjen e kontrollorëve të trafikut ajror i quajtur FEAST (nga anglishtja: *First European Air Traffic Controller Selection Test*), (Ref. UTP, 1. *Selection of candidates for student air traffic controllers*), test ky të cilin shumica absolute e OSHNA-ve të Europës e përdorin për rekrutimin e KTA-ve, për arsye se është testi më profesional dhe më transparent. Me FEAST mund të nxjerret direkt lista përfundimtare e kandidatëve të suksesshëm, meqë rezultatet janë në kohë reale dhe të përlllogaritura në mënyrë kompjuterike. (Më shumë informata rreth FEAST mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit <http://feast-info.eurocontrol.int/>)
- 6.2.4 Kandidatët e përzgjedhur pas kësaj faze, do të jenë të renditur në bazë të performancës së përgjithshme në testet profesionale, d.m.th nga kandidati me pikët më të larta deri te ai me pikët më të ulëta. Kjo listë do të përmbajë edhe një numër shtesë të kandidatëve, si listë e kandidatëve në pritje sepse kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen edhe testeve të detyrueshme mjekësore.

6.3 Testet / kontrollet mjekësore

- 6.3.1 Të gjithë kandidatët e përzgjedhur pas testeve profesionale, do t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore në AMC (Qendrat e Mjekësisë së Aviacionit).
- 6.3.2 Të gjitha shpenzimet për kontrollet mjekësore do të mbulohen nga ASHNA.
- 6.3.3 Në rast të dështimit të ndonjërit kandidat për të kaluar testet mjekësore kandidatët nga lista e pritjes do të ftohen me radhë për t'ju nënshtrouar testeve mjekësore.

7. Lista përfundimtare

Kandidatët që kalojnë me sukses të gjitha fazat e testimit, do të formojnë listën përfundimtare të kandidatëve për student-kontrollor të renditur sipas pikëve të fituara në FEAST.

8. Statusi i nëpunësit nëpër faza

Kontrollori i ardhshëm në ASHNA do të kalojë nëpër këto faza:

8.1 Kandidat për Student-Kontrollor

Kandidat për Student Kontrollor është personi i cili është përzgjedhur për të filluar trajnimin profesional. Pas procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të suksesshëm, DBNJ ofron aktin e marrëdhënies së punës për "Kandidatin për student-kontrollor" me afat dhe kushte të caktuara, duke filluar nga data e fillimit të trajnimit profesional.

8.2 Student Kontrollor

Student-Kontrollor është nëpunësi i cili ka kaluar të gjitha fazat e përzgjedhjes dhe trajnimit (ab-initio) në njërin nga qendrat për trajnimin e Kontrollorëve të Trafikut Ajror dhe ka marrë licencën nga AACK-ja si Student Kontrollor, për të cilin ASHNA do të organizojë trajnimin e duhur praktik (OJT) në DATS. Statusi Student Kontrollor zgjat deri në momentin e pajisjes me Licencë të Kontrollorit të Trafikut Ajror





me së paku një miratim të njësisë (Rregullorja 19/2017 e AAC-së dhe UTP). DBNJ obligohet të vazhdojë aktin e marrëdhënies së punës jo të karrierës me afat dhe kushte të caktuara.

8.3 Kontrollor i Trafikut Ajror

Kontrollor i Trafikut Ajror është nëpunësi i licencuar me së paku një miratim (ref. Rregullore 19-2017 e AACK-së, nënpjesa B, Licencat, Gradimet dhe Miratimet, ATCO.B.005 Licenca e kontrollorit të trafikut ajror). Ndërsa DBNJ ofron aktin e marrëdhënies së punës pas licencimit me status të karrierës.

9. Të drejtat dhe detyrimet

9.1 Në raport me nëpunësin, ASHNA obligohet:

- Të paguajë për shkollimin, akomodimin, sigurimin shëndetësor, transportin deri në destinacion (dhe një rrugëtim vajtje/ardhje për në shtëpi gjatë kohës së trajnimit);
- Të paguajë pagë mujore deri në Licencim me së paku një miratim, të përcaktuar me paragrafin 11, pika a) si më poshtë;
- Të organizojë Trajnimin në Punë (OJT) në DATS deri në Licencim me së paku një miratim;

ASHNA nuk ka asnjë përgjegjësi kontraktuale ndaj nëpunësit që nuk mund të kalojë të gjitha fazat e trajnimit në licencim.

9.2 Në raport me ASHNA-në, nëpunësi:

- Obligohet të punojë në ASHNA për 7 (shtatë) vite pandërprerë, duke filluar nga data e licencimit me së paku një miratim. Në të kundërtën, nëpunësi detyrohet të paguajë shumën prej 100.000,00€ (njëqindmijë euro) si kundërvlerë për shkëputje të njëanshme të kontratës;
- Obligohet të paguajë të gjitha shpenzimet për përzgjedhjen dhe shkollimin e tij deri në atë moment, në rast të ndërprerjes së njëanshme të kontratës para marrjes së miratimit të parë;
- Zotohet të ruajë kredibilitetin e ASHNA-së duke e përfaqësuar denjësisht atë në institutet e trajnimit dhe jo vetëm;

Nëpunësi nuk ka përgjegjësi ndaj ASHNA-së në rast të dështimit për mbërritjen e standardeve të kërkuara, në secilën prej fazave të trajnimit.

10. Përfaqësimi sindikal i Kontrollorit të ardhshëm të Trafikut Ajror

Kontrollori i ardhshëm ka të drejtë për përfaqësim sindikal dhe kështu gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërmjet Sindikatës dhe menaxhmentit.

11. Skema e kompensimit të nëpunësit

Kontrollori i ardhshëm në ASHNA do të ndjekë këtë skemë të kompensimit:



Njësia Organizative: ASHNA
Nr. Ref./Kodi: ASHNA – REK – KTA
Ver.: 1.1
Data e Ver.: 21.10.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

-
- | | |
|-------------------------------------|----------|
| a) Kandidat për student-kontrollor: | ASHNA 1C |
| b) Student Kontrollor: | ASHNA 3C |
| c) Kontrollor i licencuar: | ASHNA 5B |

12. Dispozitat kalimtare

I tërë procesi i rekrutimit mund të zgjasë për aq sa është e nevojshme mirëpo jo më shumë se 90 ditë.

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 01.11.2021



Njësia Organizative: ASHNA
Nr. Ref./Kodi: ASHNA – REK – KTA
Ver.: 1.1
Data e Ver.: 21.10.2021

Faqe 11 nga 11